



**TANI!**

**AFGANISTANI, NIGERIA, IRLANDA VERIORE,  
RUSIA, GUATEMALA, PAKISTANI, KAMBOXHIA.**



# “Është e pamundur të mos inspirohesh nga kaq shumë shembuj të larmishëm të guximit!”

THE WASHINGTON POST

## SHTATË

e krijuar nga Paula Cizmar, Catherine Filloux, Gail Kriegel, Carol K. Mack, Ruth Margraff, Anna Deveare-Smith dhe Susan Yankowitz, në bashkëpunim me Vital Voices Global Partnership.

SHTATË është një shfaqje dokumentare inovative e bazuar në intervistat me shtatë aktiviste të të drejtave të grave nga e gjithë bota. Intervistat u zhvilluan në vitin 2007 nga shtatë dramaturge të vlerësuara me çmime.

*“Shfaqja portretizon fuqishëm rrugën e shndërrimit të shtatë grave të guximshme të cilat kanë ndryshuar shoqërinë e tyre për më mirë - nga vendosja e paqes, lufta kundër korrupsionit, tek lufta e dhunës ndaj gruas.”*

**SEKRETARJA AMERIKANE E SHTETIT, HILLARY CLINTON**

Në vitin 2008 në Suedi, tekstshkruesja çmim-fituese, aktorja dhe producentja Hedda Krausz Sjögren inicioi një tur dhe koncept inovativ të prodhimit të “SHTATË” që u zgjodh nga Swedish National Touring Theatre. Duke i vendosur vendimmarrësit, si politikanët dhe zyrtarët qeveritarë në skenë së bashku me aktorët, figurat publike dhe aktivistët për të portretizuar shtatë gratë në shfaqje, tashmë në vitin e tij të katërt, turneu ka arritur një numër prej 15 mijë njerëzish në 12 shtete. 500 politikanë dhe figura publike të mediave ku përfshihen edhe shtatë anëtarë të Parlamentit Evropian, Ministrja Suedeze për Drejtësi Znj. Beatrice Ask, policia e lartë dhe zyrtarët ushtarakë, të gjithë janë futur në skenë për t'i dhënë zë rolit në shfaqje.

Në çdo vend performojnë një ansambël unik i aktorëve, politikanëve, studentëve dhe aktivistëve, meshkuj dhe femra. Organizatat dhe agjensitë lokale dhe kombëtare bashkëpunojnë për të organizuar panele diskutimi, demonstrata, ligjërata e të tjera.



**“Fuqia e teatrit për të ndryshuar botën.”**

**ARBETAREN**



# SHTATË femrat



## **FARIDA AZIZI, AFGANISTAN**

Farida Azizi u bë aktiviste duke luftuar marginalizimin e grave nën sundimin Taliban në vendlindjen e saj. Pas kërcënimeve të shumta për jetën, ajo ka fituar azil dhe tani jeton në Shtetet e Bashkuara me dy fëmijët e saj dhe punon për të drejtat e grave dhe për ndërtimin e paqes në Afganistan.



## **INEZ MCCORMACK, IRLANDA VERIORE, 1943 - 2013**

Inez McCormack e cila u rrit në një familje protestante në Belfast, bëri të pamenduarën dhe u martua me një katolik. Prej të 60-ave ajo ishte një aktiviste për të drejtat e grave dhe të njeriut, të fuqisë punëtore dhe të drejtësisë shoqërore. Ishte presidente e Kongresit Irlandez të Sindikatave. Znj.McCormack luajti rol të rëndësishëm në Good Friday Peace Accords në vitin 1998. Ajo vazhdoi luftën e saj për të paprivilegjuar deri në janar të vitit 2013 kur ndërroi jetë pas një sëmundjeje.



## **MARINA PISKLAKOVA - PARKER, RUSI**

Në vitin 1993, pas mosmarrëveshjeve të jashtëzakonshme, Marina Pisklakova - Parker themeloi linjën e parë telefonike për viktimat e dhunës në familje, e cila prej atëherë u shndërrua në qendrën ANNA, pjesë e koalicionit që ka këshilluar rreth 100,000 gra ruse.



## **ANNABELLA DE LEON, GUATEMALA**

Annabella nxorri veten dhe familjen e saj nga varfëria përmes edukimit. Kongresiste që nga viti 1995, ajo ka marrë shumë kërcënime me vdekje për shkak të luftës së saj kundër korrupsionit dhe për të drejtat e të varfërve, veçanërisht për gratë dhe popullsinë vendase.



## **MUKHTAR MAI, PAKISTAN**

Mukhtar Mai u përdhunua nga katër burra dhe u detyrua të ecte drejt shtëpisë pothuajse e zhveshur si ndëshkim për një "krim nderi". Znj.Mai dhe historia e saj pikëlluese rrëmbeu kryetitujt në të gjithë botën. Në vend që të merrete rrugën e grave tradicionale e të bënte vetëvrasje, ajo i vuri dhunuesit e saj përpara drejtësisë, ndërtoi shkollë për të përmirësuar gjendjen e grave, dhe u bë avokate për edukimin në vendin e saj.



## **MU SOCHUA, KAMBOXHIA**

Mu Sochua, ish-Ministre e Çështjeve të Grave në Kamboxhia (një nga dy gratë e vetme të kabinetit), në vitin 2005 u bashkë-nominua për çmimin Nobel për Paqen për punën e saj kundër trafikimit në Kamboxhia dhe Tajlandë. Mu Sochua, pasi shkoi derë më derë në 482 fshatra, në korrik të vitit 2008 fitoi një vend në Parlament.



## **HAFSAT ABIOLA, NIGERI**

Hafsat Abiola, mbrojtëse e të drejtave të njeriut dhe demokracisë pas vrasjes së prindërve të saj aktiviste, themeloi Iniciativën Kudirat për Demokraci e cila ofron mundësi për trajnime aftësuese dhe të udhëheqjes për të gjitha gratë në Nigeri.

# SHTATË në numra

**19** shtete janë përfshirë në turneun e SHTATË-s: Suedia, Holanda, Turqia, Belgjika, Nigeria, Finlanda, Serbia, Rusia, Danimarka, Lituania, Jordania, Afganistani, India, Maqedonia, Shqipëria, Kroacia, Kosova, Bosnje-Hercegovina, Maroku.

**500** politikanë, aktorë, gazetarë dhe shumë aktivistë të tjerë kanë lexuar një rol në SHTATË.

**1** aktore e cila ka fituar Oscar ka performuar në SHTATË - Meryl Streep në vitin 2010 në Nju Jork.

**7** anëtarë të Parlamentit Evropian kanë performuar SHTATË-n brenda Parlamentit Evropian.

**6** ministra të kabinetit Suedez kanë performuar SHTATË-n.

**7** politikanë meshkuj kanë performuar shtatë rolet e femrave në Parlamentin Suedez.

**1** Sekretare e ndihmës së huaj ka mbajtur një fjalim hyrës - Gunilla Carlsson, Stokholm, 2009.

**60 +** organizata dhe agjensi janë përfshirë rreth performancës së SHTATË-s në mbarë botën.

## SHTATË është një PROVË

Regjisorja dhe producentja, Hedda Krausz Sjögren vazhdon t'i ftojë në bashkëpunime institucionet qeveritare, organizatat, kompanitë, universitetet dhe teatrot e tjera që ta sjellin SHTATË-n tek një audiencë më e gjerë. Kë do të dëshironit ta shihnit duke performuar SHTATË-n? Kontaktoni Hedda Krausz Sjögren sot!

Hedda Krausz Sjögren me Parlamentarë Suedez, Cecilia Wikström (FP), Bodil Ceballos (MP), Abir Al-Sahlan (C), Kajsa Borgnäs (S), Kristina Axén Olin (M), Aminah Kakabaveh (V), Desirée Pethrus Engström (KD). Photo: Stig Hammarstedt.



# SHTATË në turne

## - BALLKAN 2013

Në vitin 2013 SHTATË do të udhëtojë në gjashtë shtete të Ballkanit: në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Maqedoni dhe Serbi.

Në Shqipëri, SHTATË organizohet për herë të parë.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), një organizatë jofitimprurëse shqiptare, që ofron shërbim ligjor falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore, ka marrë përsipër organizimin e shfaqjes SHTATË në bashkëpunim të ngushtë me Ambasadën Suedeze në Tiranë dhe Civil Rights Defenders.

Turneu suedez i SHTATË-s është një projekt ndërkombëtar i cili ka filluar në 2008 me ndihmën e produksionit të pavarur dhe sektorit të burimeve INTERCULT dhe si pjesë e Vitit Evropian të Dialogut Ndërkulturor.

Nën drejtimin dhe prodhimin e Hedda Krausz Sjögren dhe në bashkëpunim me Swedish National Touring Theatre (Riksteatern), Institutin Suedez, Ambasadat Suedeze dhe partnerët lokalë, SHTATË ka pasur mundësinë të udhëtojë vazhdimisht.

SHTATË është përkthyer sot në gjuhën suedeze, turke, serbe, frënge, spanjolle, finlandeze, ruse, daneze, lituane, dari, shqipe, maqedonase dhe arabe.

Shtatë politikanë meshkuj duke ushtruar shtatë role femrash në Parlamentin Suedez. Nga e majta: Hedda Krausz Sjögren, Mats Sander (M), Michael Anefur (KD), Fredrik Malm (FP), Mikael Damberg (S), Jacob Johnson (V), Staffan Danielsson (C) and Mats Perotto (MP). Foto: Anna Huerta



Hillary Clinton, Inez McCormack dhe Meryl  
Streep pas performancës së SHTATË-s, Mars 2010.  
Foto: Vital Voices



## SHTATË është THIRRJE!

Shtatë u krijua në bashkëpunim me Vital Voices Global Partnership. Misioni i tyre është të identifikojë, investojë në dukshmërinë e grave të jashtëzakonshme të të gjithë botës duke e çliruar potencialin e tyre të lidërshiptit për të ndryshuar jetën dhe për të përshpejtuar paqen dhe përparimin në komunitetet e tyre. [www.vitalvoices.org](http://www.vitalvoices.org).

Ka shumë më tepër histori të pathëna që bota ka nevojë t'i dëgjojë. SHTATË është thirrje për femra të tjera të guximshme që të ndajnë historitë dhe të vërtetat e tyre. A do të na e thoni historinë tuaj?

### **NJIHUNI ME PROJEKTIN:**

Shiko: [www.sevenwomen.se/en](http://www.sevenwomen.se/en)

E-mail: [hedda@sevenwomen.se](mailto:hedda@sevenwomen.se)

 @SevenHedda

 Seven on Tour

### **Hedda Produktion AB**

është një kompani produksioni që vepron jashtë Stokholmit, Suedi. Hedda Krausz Sjögren aktore, shkrimtare dhe konsulente ka marrë çmimin vjetor Riksteatern në 2009, dhe çmimin Hans Ullberg në 2010 për punën e saj me SHTATË-n duke përfshirë përkthimin e shfaqjes, inicimin dhe drejtimin e turneut ndërkombëtar Suedez të SHTATË-s.

[www.hedda.nu](http://www.hedda.nu)



# SHTATË NË TURNE - Ballkan 2013



EMBASSY OF SWEDEN

Belgrade • Pristina • Skopje  
• Sarajevo • Tirana • Zagreb

[www.qag-al.org](http://www.qag-al.org)  
[www.sevenwomen.se/en](http://www.sevenwomen.se/en)